

VENDIM
Nr. 21, datë 13.1.2022

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “REHABILITIMI I FUSHËS SPORTIVE LAPRAKË”, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi i fushës sportive Laprakë”, Tiranë.
2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Tiranë.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, në shumën e përgjithshme prej 155 595 496 (njëqind e pesëdhjetë e pesë milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekësh.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 155 595 496 (njëqind e pesëdhjetë e pesë milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekësh, të përballohet nga buxheti i Bashkisë Tiranë.
5. Vlera për shpenzimet procedurale, prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh, të përballohet nga fondet e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.
6. Shpronësimi i pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin për likuidim, certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë, si dhe hartën kadastrale në zyrat e Bashkisë Tiranë.
8. Bashkia Tiranë të kryejë procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Tiranë.
10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Veri, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjë regjistrimin e kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuar në favor të Bashkisë Tiranë.
11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Veri, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale.
12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Tiranë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Veri për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

LLOGARITJET PËRFUNDIMTARE PËR PASURITË QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT “REHABILITIMI I FUSHËS
SPORTIVE LAPRAKË”, TIRANË

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	Lloji i pasurisë	ZK	Nr. i pas.	Sip. e përgj. e truallit m ²	Sip. e prekur e truallit m ²	Çmimi për truall lekë/m ²	Vlera në lekë	Lloji i dokumentit	Shënime në kartelë
1	B.P. Shemsiu, Gjeli, Mati, Isaj, Shkupi, Dashi, Pustina, Dollani, Hoxhaj, Kurani, Tamburi, etj	Truall	8310	9/177	5,388	4,984	31219	155595496	Shkresa nr. prot. 9057, datë 18.3.2019, e ZVRPP Tiranë	Ka ndërtim të paligjshëm.
Vlera totale paraprake					5,388	4,984	31219	155595496		

1. Llogaritja përfundimtare është bazuar në shkresën nr. 9057 prot., datë 18.3.2019, të ZVRPP Tiranë.
2. Për truallin çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja nr. 89, datë 3.2.2016.